

**Vendim nr. 16 datë 27.06.2022**

**(V-16/22)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Elsa Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.06.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 2(Gj) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË**

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
KËSHILLI I MINISTRAVE,  
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR,  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME.**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i togfjalëshit “paragrafi 2”, pas “244”, në shkronjën “a” të nenit 7 të ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 135, pika 2 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 68 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar shfuqizimin e dispozitës sipas objektit, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave, Prokurorisë së Përgjithshme, të cilat kërkuan

rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Në gusht të vitit 2020 shtetasi J.X. ka kaluar nga kufiri i gjelbër për në shtetin grek, ku ka qëndruar deri në korrik të vitit 2021. Në orën 23:15 të datës 22.07.2021 ai është paraqitur në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës për të hyrë në territorin shqiptar.

2. Gjatë kryerjes së procedurave të regjistrimit të shtetasve që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, J.X. i ka ofruar një kartëmonedhë 20 euroshe punonjësit të policisë së pikës së kalimit kufitar, me qëllim që ky i fundit ta lejonte të hynte pa probleme, duke qenë se kishte dalë nga territori shqiptar përmes kufirit të gjelbër.

3. Për këtë shkak, autoritetet ligjzbatuese kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit J.X. dhe kanë nisur hetimet për kryerjen prej tij të veprës penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal (*KP*).

4. Në datën 25.10.2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 626 të vitit 2021, në ngarkim të shtetasit J.X.

5. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancën e datës 22.11.2021, gjykata referuese ka shtruar për diskutim çështjen e kushtetutshmërisë së togfjalëshit “paragrafi 2”, pas “244”, në shkronjën “a” të nenit 7 (*dispozita e kundërshtuar*) të ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 41/2021*). Në përfundim, me vendimin e ndërmjetëm nr. 520005-01735-41-2021, datë 22.11.2021, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin si antikushtetues të këtij togfjalëshi. Ky vendim, së bashku me dosjen gjyqësore, i janë përcjellë kësaj Gjykate me shkresën nr. 1 prot., datë 21.01.2022 të gjykatës referuese.

6. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) ka përcaktuar llojet e veprave penale, gjykimi i të cilave përfshihet në kompetencat e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Gjykata e Posaçme*), ndërsa neni 7 i ligjit nr. 41/2021 parashikon: “Në nenin 75/a shkronja “a” ndryshohet si më poshtë: “a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi

2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal.”.

7. Ligji nr. 43/2021, datë 23.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 43/2021), përcakton në nenin 244, paragrafi i parë, se: “*Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit*”, ndërsa paragrafi i dytë i po këtij neni parashikon se: “*Po kjo veper, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.*”.

8. Me vendimin e datës 04.03.2022, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 28.03.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Gjykata referuese**, në mbështetje të kërkesës së saj për inicimin e kontrollit incidental të normës ligjore, ka parashtruar si vijon:

9.1. Për sa i përket *legjitimitit si gjykatë referuese*, ajo përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese në drejtim të identifikimit të ligjit ose normës që do të zbatohet në çështjen konkrete për shqyrtim para saj; parashtrimin të arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës ligjore, referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; lidhjes së drejtpërdrejtë mes ligjit të dyshuar si antikushtetues dhe zgjidhjes së çështjes konkrete; pamundësisë për të kryer interpretim pajtues të ligjit, pasi nuk ekziston asnjë dispozitë tjetër, e cila mund të zbatohet për çështjen objekt gjykimi dhe parashikimi ligjor i kundërshtuar nuk mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë.

9.2. Dispozita e kundërshtuar cenon *parimin e gjykatës së caktuar me ligj*, pasi ngushton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, duke zgjeruar kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kundërshtim me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton kompetencën lëndore për gjykimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme, kompetencë e cila sipas nenit 74 të

KPP-së është mbetëse e asaj të caktuar posaçërisht gjykatave të posaçme sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a të KPP-së. Kompetenca lëndore e gjykatave të posaçme që gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar është rregulluar drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, e cila nuk ka deleguar mundësinë e rregullimit të saj me ligj. Në referim të dispozitës së kundërshtuar, gjykatat e posaçme do të shqyrtojnë vetëm veprat penale të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 244 të KP-së, ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm krimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

9.3. Dispozita e kundërshtuar cenon *parimin e hierarkisë së normave*, pasi atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Përmbajtja e pikës 2 të nenit 135 të Kushtetutës, që përcakton gjykatat e posaçme si gjykata kompetente për gjykimin e veprave penale të korrupsionit, nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet, duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të saj, konkretisht parashikimeve të ligjit nr. 41/2021.

9.4. Dispozita e kundërshtuar cenon *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, për sa i përket shpërndarjes së kompetencës legjislativë, si dhe *parimin e sigurisë juridike*, si elemente të shtetit të së drejtës, pasi dispozita e kundërshtuar ngushton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, duke zgjeruar kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në tejkallim të rregullimit kushtetues të parashikuar në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit veprat penale të korrupsionit gjykohen nga gjykatat e posaçme.

10. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

10.1. Gjykata referuese nuk përmbush kriteret e legjitimitit për inicimin e kontrollit kushtetues të dispozitës, pasi nuk ka arritur të analizojë dhe vërtetojë lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me zgjidhjen e çështjes konkrete. Dispozita e kundërshtuar parashikon kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme, për rrjedhojë kompetente për ushtrimin e kontrollit kushtetues të normës në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, do të ishte ajo gjykatë. Po kështu, kjo gjykatë nuk ka parashtruar arsye serioze për antikushtetueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar.

10.2. Rregullimi kushtetues i nenit 135, pika 2, të Kushtetutës nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai nuk është i plotë dhe shterues, pasi nuk përmban elementet e domosdoshme që lidhen me ushtrimin efektiv dhe real të kompetencës lëndore nga gjykatat e posaçme. Ky nen përbën një dispozitë me karakter lejues, pasi ndërkohë që përcakton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, nuk parashikon asnjë ndalim që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm

të gjykojnë veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Kushtetutëbërësi nuk ka përcaktuar në mënyrë shteruese veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që do të jenë në kompetencën e Gjykatës së Posaçme.

- 10.3. Ndryshimet në nenin 75/a të KPP-së kanë ardhur paralelisht me ndryshimet në nenin 244 të KP-së. Ligjvënësi ka ushtruar pushtetin dhe diskrecionin e tij për krijimin e një mekanizmi efikas të hetimit (përmes SPAK-ut) dhe gjykimit penal (përmes Gjykatës së Posaçme) për të goditur veprimtarinë kriminale në nivele të larta, duke e përqendruar veprimtarinë e këtyre organeve në veprat penale që sjellin pasoja të rënda dhe serioze në shoqëri. Kjo veprimtari dhe politikë legjislative e Kuvendit do të cenohej nëse këto organe do të mbingarkoheshin me çështje. Zbatimi i dispozitës së kundërshtuar nuk sjell asnjë ndikim negativ, përveç riorganizimit procedural të kompetencës së gjykatave të posaçme. Ajo ndikon në mënyrë indirekte edhe në garantimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor, përfshirë edhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.
- 10.4. Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e posaçme e kanë pranuar kompetencën e tyre lëndore për gjykimin e çështjeve sipas përcaktimit të nenit 75/a të KPP-së dhe nuk kanë ngritur pretendime për ndryshimin ligjor të bërë përmes ligjit nr. 41/2021 në raport me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës. Në rast se norma juridike do të kishte hasur problematika të natyrës kushtetuese për kompetencën, këto organe do të ishin të parat që do t'i kishin paraqitur ato në Gjykatë, përmes kontrollit incidental.
- 10.5. Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata referuese nuk ka dhënë asnjë argument në mbështetje të tij.

11. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- 11.1 Gjykata referuese nuk përmbush kriteret e legjitimitit për inicimin e kontrollit kushtetues të dispozitës, pasi nuk ka arritur të analizojë dhe vërtetojë lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me zgjidhjen e çështjes konkrete. Dispozita e kundërshtuar parashikon kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme, për rrjedhojë kompetente për ushtrimin e kontrollit kushtetues të normës në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, do të ishte ajo gjykatë. Po kështu, kjo gjykatë nuk ka parashtruar arsye serioze për antikushtetueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar.

- 11.2 Rregullimi kushtetues i nenit 135, pika 2, të Kushtetutës nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai nuk është i plotë dhe shterues, pasi nuk përmban elementet e domosdoshme që lidhen me ushtrimin efektiv dhe real të kompetencës lëndore nga gjykatat e posaçme. Ky nen përbën një dispozitë me karakter lejues, pasi, ndërkohë që përcakton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, nuk parashikon asnjë ndalim që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të gjykojnë veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Kushtetutëbërësi nuk ka përcaktuar në mënyrë shteruese veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që do të jenë në kompetencën e Gjykatës së Posaçme.
- 11.3 Ndryshimet në nenin 75/a të KPP-së kanë ardhur paralelisht me ndryshimet në nenin 244 të KP-së. Përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në varësi të vlerës së përfitimit, krijon mundësi reale që Prokuroria e Posaçme të fokusohet në ato çështje penale, të cilat kanë rëndësi të veçantë për shkak të natyrës së tyre, rrezikshmërisë së lartë shoqërore, ndikimit të pasojave që sjellin në shoqëri, si dhe nivelit të korrupsionit. Përcaktimi i kufijve monetarë për cilësimin e kësaj vepre penale, duke përshtatur edhe masat e dënimit, ka synuar përmirësimin e zbatimit të këtyre dispozitave nga organet proceduese në funksion të qëllimit primar, atij të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.
- 11.4 Dispozita objekt gjykimi kushtetues synon, gjithashtu, edhe garantimin e standardit të procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë edhe atë të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Ndryshimet ligjore të vitit 2021 për ushtrimin në mënyrë efikase të ndjekjes penale janë vlerësuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë, duke u konsideruar të rëndësishme për funksionimin eficient të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë shqiptare, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- 11.5 Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata referuese nuk ka dhënë asnjë argument në mbështetje të tij.

12. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se norma juridike e pretenduar si antikushtetuese nga gjykata referuese nuk cenon bazat e funksionimit të shtetit dhe parimet bazë të organizmit shtetëror e shoqëror të mbrojtura nga Kushtetuta. Sipas tij:

- 12.1. Gjykata referuese legjitimohet në kërkesën e saj për vënien në lëvizje të Gjykatës, për shkak të parashikimit të neneve 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145 të Kushtetutës.
- 12.2. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të hierarkisë së normave, gjykata referuese ka bërë interpretim formal gjuhësor të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, duke arritur në konkluzione të gabuara për antikushtetutshmërinë e pretenduar të normës.
- 12.3. Ligji nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ligji nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (*ligji nr. 95/2016*), si dhe ligji nr. 35/2017, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” janë pjesë e paketës së reformës në drejtësi, të miratuara nga ligjvënësi në të njëjtin kontekst historik. Përmes tyre ligjvënësi është kujdesur në mënyrë të veçantë për korrupsionin serioz, i cili krijon premisa të ndërlidhjes me krimin e organizuar, çka rrezikon bazat e shtetit dhe organizimin shoqëror.
- 12.4. Përmes parashikimeve të nenit 135 të Kushtetutës ligjvënësi nuk ka pasur si qëllim përjashtimin kushtetues të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nga gjykimi i veprave penale të korrupsionit. Ky nen përcakton juridiksionin lëndor të Gjykatës së Posaçme në mënyrë të përgjithshme, ndërsa juridiksioni në kuptimin e ngushtë përcaktohet në nenin 75/a të KPP-së. Ndërkohë që këto kompetenca nuk mund të zgjerohen tej atyre të parashikuara në Kushtetutë, nuk ndalohet ngushtimi i tyre për një fokusim më të mirë në çështjet serioze të korrupsionit.
- 12.5. Gjykata referuese nuk ka bërë argumentim specifik për bazueshmërinë e pretendimeve për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe të sigurisë juridike. Këto pretendime janë rrjedhojë e atyre për cenimin e parimit të hierarkisë së normave, pra argumente të devijuara prej tyre dhe jo si të tilla në vetvete.
13. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.



### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

14. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që mundëson fillimin e procesit kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental parashikohet në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i cili u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, të vendosin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e normës. Kjo dispozitë, e konkretizuar edhe në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve nga Gjykata, kur ky kontroll kërkohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka zhvilluar disa standarde për legjitimitimin e gjykatës referuese për inicimin e kontrollit incidental të normës ligjore për pajtueshmërinë e saj me Kushtetutën. Sipas këtyre standardeve, gjykata referuese duhet që gjatë procesit gjyqësor: (i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhja e drejtpërdrejtë); (ii) të parashtojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; (iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 24, datë 04.05.2021; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kriteret e mësipërme janë kumulative dhe mjafton mosplotësimi i vetëm njërit prej tyre që gjykata referuese të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa u takon kriterëve të legjitimitimit të gjykatës referuese për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, Gjykata ka theksuar se në kuptim të përmbajtjes së nenit 145 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, gjykata referuese në vendimin për pezullimin e gjykimit dhe inicimin e kontrollit kushtetues, është e detyruar të përcaktojë dispozitat e ligjit të zbatueshëm dhe të argumentojë ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë, pra që midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete ekziston një marrëdhënie juridike konkrete, reale dhe aktuale (*shih vendimin nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).



18. Në rastin konkret, gjykata referuese parashtron se legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi ajo ka identifikuar dispozitën që çmohet si antikushtetuese, konkretisht togfjalëshin “paragrafi 2”, pas “244”, në shkronjën “a” të nenit 7 të ligjit nr. 41/2021, si dhe ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis saj dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

19. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se gjykata referuese nuk përmbush kriteret e legjitimitimit për iniciimin e kontrollit kushtetues të dispozitës, pasi nuk ka arritur të analizojë dhe vërtetojë lidhjen e drejtpërdrejtë të dispozitës së kundërshtuar me zgjidhjen e çështjes konkrete për shqyrtim para saj. Sipas tyre, dispozita e kundërshtuar parashikon kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme, për rrjedhojë kompetente për ushtrimin e kontrollit kushtetues të normës do të ishte ajo gjykatë. Po kështu, Prokuroria e Përgjithshme ka parashtruar se gjykata referuese legjitimohet në kërkesën e saj për vënien në lëvizje të Gjykatës për shkak të parashikimeve të neneve 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145 të Kushtetutës.

20. Gjykata konstaton se gjykata referuese, pasi ka shqyrtuar rrethanat e çështjes, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të saj, duke iu drejtuar Gjykatës sipas procedurës së parashikuar nga ligji nr. 8577/2000. Ajo ka identifikuar togfjalëshin “paragrafi 2”, pas “244”, në përmbajtje të shkronjës “a” të nenit 7 të ligjit nr. 41/2021, si dispozita ligjore e zbatueshme për zgjidhjen e rastit konkret. Në vijim, gjykata referuese ka argumentuar se ky togfjalësh bie ndesh me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, duke cenuar parimet e gjykatës së caktuar me ligj, të hierarkisë së normave, të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, në drejtim të shpërndarjes së kompetencës legjislative, si dhe të sigurisë juridike, si elemente të shtetit të së drejtës, pasi atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji.

21. Gjykata vëren se neni 7 i ligjit nr. 41/2021 ka bërë ndryshime në nenin 75/a të KPP-së “Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, për sa i përket përcaktimit të veprave penale që hyjnë në kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, duke parashikuar, ndër të tjera, kompetencën lëndore të këtyre gjykatave për gjykimin vetëm të veprës penale, të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 244 të KP-së “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

22. Referuar rrethanave të faktit (*shih paragrafin 2 të vendimit*), rasti në shqyrtim nga gjykata referuese hyn në hipotezën e parashikuar nga neni 244, paragrafi i parë, i KP-së. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kompetenca lëndore e gjykatës referuese parashikohet në nenin 74 të KPP-së, sipas të cilit gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës së Posaçme. Pra, dispozita e nenit 74 të KPP-së bën drejtpërdrejt të zbatueshëm nenin 75/a të KPP-së. Ky i fundit përcakton

kompetencat e Gjykatës së Posaçme, prandaj neni 74 i KPP-së nuk mund të zbatohet pa pasur parasysh përmbajtjen e nenit 75/a të KPP-së.

23. Për sa më lart, Gjykata vlerëson, se në ndryshim nga sa kanë pretenduar subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, gjykata referuese ka identifikuar normën e zbatueshme, si dhe ka arritur të argumentojë ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë, pra që midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete ekziston një marrëdhënie juridike konkrete, reale dhe aktuale.

24. Në lidhje me kriterin “arsye bindëse/serioze” për antikushtetutshmërinë e normës ligjore, gjykata referuese ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi përfshin në kompetencën lëndore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm shqyrtimin e çështjeve të cilat sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës i përkasin kompetencës së Gjykatës së Posaçme, si dhe parimin e hierarkisë së normave, të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të sigurisë juridike, pasi atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji.

25. Subjektet e interesuara Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave kanë pretenduar se gjykata referuese nuk ka parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, pasi argumentet e saj nuk janë të mjaftueshme për të provuar në nivel kushtetues cenimin e neneve 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme ka pretenduar se gjykata referuese ka arritur në konkluzione të gabuara për antikushtetutshmërinë e pretenduar të normës.

26. Gjykata vëren se gjykata referuese ka parashtruar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të hierarkisë së normave, të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, për sa i përket parimit të shpërndarjes së kompetencës legjislativë, si dhe të sigurisë juridike. Sipas saj, dispozita e kundërshtuar cenon parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të sigurisë juridike, pasi ngushton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, duke zgjeruar kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në tejkalim të rregullimit kushtetues të parashikuar në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit veprat penale të korrupsionit gjykohen nga gjykatat e posaçme.

27. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka arritur të përcaktojë se si, përmes parashikimit të dispozitës së kundërshtuar, është ndërhyrë në kompetencat e një prej pushteteve të tjera në kuptimin klasik. Pretendimet e saj në këtë drejtim kanë të bëjnë me shpërndarjen e kompetencës brenda të njëjtit pushtet, konkretisht atij gjyqësor, për shkak të gjykimit të veprës penale të korrupsionit, të parashikuar nga neni 244, paragrafi i parë, i KP-së nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërsa asaj të parashikuar

nga paragrafi i dytë i këtij neni nga gjykatat e posaçme, çka në thelb ka të bëjë me parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

28. Për rrjedhojë, Gjykata çmon ta analizojë çështjen vetëm për kushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar në lidhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, për të cilin Gjykata vlerëson se janë parashtruar argumente bindëse dhe serioze në drejtim të kompetencës së gjykatave për veprën penale të korrupsionit, duke u plotësuar në këtë mënyrë kriteret e legjitimitimit, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000.

## *B. Për themelin e pretendimeve*

### *B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj*

29. Gjykata referuese ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar ngushton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, duke zgjeruar kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, çka bie në kundërshtim me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton kompetencën lëndore për gjykimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme, kompetencë e cila sipas nenit 74 të KPP-së është mbetëse e asaj të caktuar posaçërisht gjykatave të posaçme sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 75/a të KPP-së. Kompetenca lëndore e gjykatave të posaçme që gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimet të organizuar është rregulluar drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, e cila nuk ka deleguar mundësinë e rregullimit të saj me ligj. Në referim të dispozitës së kundërshtuar, gjykatat e posaçme do të shqyrtojnë vetëm veprat penale të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 244 të KP-së, ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm krimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

30. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se neni 135, pika 2, i Kushtetutës përbën një dispozitë me karakter lejues, pasi ndërkohë që përcakton kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme, nuk parashikon asnjë ndalim që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të gjykojnë veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndryshimet e bëra në nenin 75/a të KPP-së kanë ardhur paralelisht me ndryshimet në nenin 244 të KP-së dhe përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në varësi të vlerës së përfitimit krijon mundësi reale që Prokuroria e Posaçme të fokusohet në ato çështje penale të cilat kanë rëndësi të veçantë për shkak të natyrës së tyre, rrezikshmërisë së lartë shoqërore, ndikimit të pasojave që ato sjellin në shoqëri, si dhe nivelit të korrupsionit. Dispozita objekt gjykimi kushtetues synon, gjithashtu, edhe garantimin e standardit të procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë edhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Po ashtu, Këshilli i Ministrave ka parashtruar se ndryshimet ligjore të vitit 2021 për ushtrimin në mënyrë efikase të ndjekjes penale janë vlerësuar edhe nga partnerët

ndërkombëtarë, duke u konsideruar të rëndësishme për funksionimin eficient të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë shqiptare, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

31. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se përmes parashikimeve të nenit 135 të Kushtetutës ligjvënësi nuk ka pasur si qëllim përjashtimin kushtetues të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nga gjykimi i veprave penale të korrupsionit. Parashikimet e kësaj dispozite kushtetuese përcaktojnë juridiksionin lëndor të Gjykatës së Posaçme në mënyrë të përgjithshme, ndërsa juridiksioni në kuptimin e ngushtë përcaktohet në nenin 75/a të KPP-së. Ndërkohë që këto kompetenca nuk mund të zgjerohen tej atyre të parashikuara në Kushtetutë, nuk ndalohej ngushtimi i tyre drejt fokusimit më të mirë në çështje serioze të korrupsionit. Ligjvënësi është kujdesur në mënyrë të veçantë për korrupsionin serioz, i cili krijon premisa të ndërlidhjes me krimin e organizuar, çka rrezikon bazat e shtetit dhe organizimin shoqëror.

32. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të Gjykatës, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e pushtetit ligjvënës, Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjyqësor të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj”, sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 62, datë 04.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykata referuese ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi dispozita e kundërshtuar bie në kundërshtim me

nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, i cili ka përcaktuar kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme për veprën penale të korrupsionit, ndaj për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e nenit 135, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, sipas të cilave: *“1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. 2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.”*

35. Gjykata vëren se sipas nenit 135, pika 1, të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Në aspektin kushtetues, administrimi i drejtësisë është funksion i gjykatave, çka përcakton vendin e kësaj dege të pushtetit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar për të (*shih vendimet nr. 27, datë 09.05.2012; nr.14, datë 21.07.2008; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këtë kuptim, pika 1 e nenit 135 të Kushtetutës përmban rregullin e përgjithshëm që përcakton funksionin kryesor të pushtetit gjyqësor, por edhe delegimin e përgjithshëm për krijimin me ligj të gjykatave, duke i njohur të drejtën ligjvënësit të rregullojë, përveç çështjeve të organizimit dhe funksionimit të tyre, edhe ato që kanë të bëjnë me kompetencën lëndore dhe atë tokësore. Pra, rregullimi i përgjithshëm i kësaj pike është që pushteti i dhënies së drejtësisë ushtrohet vetëm nga gjykata dhe se krijimi i tyre, pavarësisht natyrës që kanë, bëhet me ligj, me ndalimin e krijimit të gjykatave të jashtëzakonshme (*pika 3 e nenit 135 të Kushtetutës*).

37. Gjykata vëren se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, kushtetutëbërësi ka rishikuar përmbajtjen e nenit 135 të Kushtetutës, me qëllim parashikimin e rregullave bazë që bëjnë të mundur rikonceptimin e një sistemi gjyqësor efikas, profesional dhe të përgjegjshëm në një shtet të së drejtës. Duke shtuar në këtë nen pikat 2 dhe 4, që përmbajnë rregullime për gjykatat e posaçme, është synuar të parashikohet në nivel kushtetues dhe për herë të parë ngritja e një gjykate të re me juridiksion lëndor të posaçëm në fushën penale, e cila ka kompetencën të gjykojë disa kategori veprash penale brenda juridiksionit të përgjithshëm

penal, konkretisht ato të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si edhe akuzat penale kundër një kategorie funksionarësh të lartë.

38. Gjykata referuese pretendon, në thelb, se pika 2 e nenit 135, mbi të cilën ajo mbështet kërkesën e saj, është shteruese, duke përcaktuar drejtpërdrejt kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme në lidhje me çdo veprë penale të korrupsionit, dhe nuk parashikon delegimin e posaçëm për rregullimin e kësaj çështjeje me ligj.

39. Në ndryshim nga sa parashtrohet nga gjykata referuese, Gjykata vlerëson se ndërsa kjo dispozitë kushtetuese përcakton juridiksionin e gjykatave të posaçme, brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, vetëm për disa kategori veprash penale, ajo jo vetëm nuk përmban një ndalim të shprehur, por as nuk mund të interpretohet se ky juridiksion përjashton kompetencën e gjykatave të zakonshme për gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin.

40. Në lidhje me gjykatat e posaçme, kategoria e veprave penale të parashikuara nga norma kushtetuese duhet të interpretohet në përputhje me qëllimin për të cilin janë ngritur strukturat e posaçme që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve të posaçme juridike që cenohen nga këto vepra. Në këtë kuptim, përdorimi i lidhëzës “dhe” në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 135 nuk është i paqëllimtë. Gjykata vlerëson se qëllimi i normës kushtetuese ka qenë të kategorizojë brenda juridiksionit penal të posaçëm ato vepra penale të të njëjtit nivel për nga rëndësia dhe natyra e tyre.

41. Gjykata vëren se vepra penale e krimit të organizuar, për shkak të rëndësisë që ka për shtetin e së drejtës, ka gjetur vend në një sërë dokumentesh ndërkombëtare, të tilla si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe protokollet e saj shtesë; Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit; Konventa Evropiane për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit, e shumë instrumente të tjera të ratifikuara edhe nga shteti shqiptar. Po ashtu, lidhur me korrupsionin, ka një sërë aktesh ndërkombëtare, ku Shqipëria është e anëtarësuar, të tilla si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006, Konventa Penale e Këshillit të Evropës për Korrupsionin, e ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001, të ndryshuar, si dhe protokollin shtesë i saj, i ratifikuar me ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004.

42. Sipas këtyre akteve ndërkombëtare, shpeshherë krimi i organizuar dhe korrupsioni shihen të ndërlidhur me njëri-tjetrin, sikurse rezulton dhe nga vetë Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Gjykata çmon se krimi i organizuar



nënkupton çdo formë organizimi mes personave që duke u karakterizuar nga qëndrueshmëria kohore dhe bashkëpunimi me njëri-tjetrin kanë si qëllim kryerjen e veprave penale serioze për të siguruar në mënyrë direkte ose indirekte përfitime financiare apo materiale, ose përmbushjen e synimeve të tjera të një veprimtarie të tillë të paligjshme.

43. Në kuptim të analizës së mësipërme, Gjykata vlerëson se në këndvështrim të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, kategoritë e veprave penale të korrupsionit duhet të jenë të tilla që për nga mënyra se si kryhen, rrethanat apo edhe pasojat e ardhura, të mund të kenë peshë të barasvlefshme me ato të krimit të organizuar, të cilat konsiderohen nga ato lloj veprash penale që rrezikojnë bazat e shtetit dhe organizimin shoqëror. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim të përfshijë të gjitha veprat penale të korrupsionit në kompetencë të gjykatave të posaçme dhe se bazuar në këtë qëllim të kushtetutëbërësit, ligjvënësi ka kategorizuar në dispozitën e kundërshtuar ato vepra penale që shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe ato që shqyrtohen nga gjykatat e posaçme, referuar vlerës së përfituar.

44. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kuvendi shfaqet edhe si interpretuesi i parë i normës kushtetuese dhe hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ligjin që do të miratohet ose me dispozita të veçanta të tij (*shih vendimin nr. 9, datë 01.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se ligjvënësi ka detyrimin kushtetues të parashikojë sipas vlerësimit të tij kufijtë e dënueshmërisë së veprave penale. Ai ka të drejtë të vendosë vetë për llojin dhe masën e veprave të dënueshme penalisht, duke caktuar edhe hapësirën e lejueshme brenda së cilës mund të veprojë gjyqtari (*shih vendimet nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Edhe në këtë rast, Gjykata vëren se është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës vepër penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre, çka është në linjë edhe me qëllimin e kushtetutëbërësit të evidentuar sa më sipër (*shih paragrafët 37-43 të vendimit*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

46. Në përfundim, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkesa e gjykatës referuese, për të gjitha argumentet e mësipërme, duhet të rrëzohet si e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577,



datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 27.06.2022**

**Shpallur më 26.07.2022**

## **MENDIM PAKICE**

1. Në gjykimin kushtetues të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*gjykata referuese*), me të cilën është kërkuar shfuqizimi pjesërisht i shkronjës “a” të nenit 7 (*dispozita e kundërshtuar*) të ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 41/2021*), si e papajtueshme me Kushtetutën, kemi qëndrim të kundërt me shumicën për sa i takon themelit dhe kemi votuar për pranimin e kërkesës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*), që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Duhet theksuar se çështja kushtetuese konkrete lidhet me vlerësimin e pajtueshmërisë së dispozitës së kundërshtuar në raport me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, nëse ky i fundit përcakton kufij të kompetencës lëndore penale midis gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatës së posaçme. Kompetenca e organit kushtetues është një çështje shumë e rëndësishme, sepse lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rolin e tij në strukturën kushtetuese, e cila nga pikëpamja e organizimit bazohet në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

3. Gjykata ka pohuar se caktimi i kompetencave të organeve kushtetuese, të pavarura nga njëra-tjetra, shpreh ndarjen e pushteteve, ndërsa bashkëveprimi midis tyre garanton balancën në ushtrimin e pushtetit. Balancimi i pushteteve, teksa kërkon ekuilibrim të kompetencave, nuk do të thotë që pesha dhe kompetenca e organeve është e njëjtë. Ai ka të bëjë me faktin se struktura institucionale shtetërore bazohet në ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, ndarje e cila tregon vendin që kushtetutëbërësi ka dashur t'i japë secilit prej tyre në përmbushjen e rolit përkatës. Nuk mund të pranohet që një organ t'i shtrijë kompetencat e tij në dëm të tjetrit. Pra, Kushtetuta ka krijuar një sistem për ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, i cili i cakton secilit rolin e tij në strukturën institucionale shtetërore dhe në realizimin e detyrave që i janë besuar (*shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 41, datë 16.05.2017; nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Ashtu siç thekson shumica, interpretimi përfundimtar i Kushtetutës është ndër funksionet më të rëndësishme të Gjykatës. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e pushtetit ligjvënës,

Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih paragrafin 32 të vendimit*).

6. Po kështu, me të drejtë, shumica ka ritheksuar se përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj”, sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih paragrafin 33 të vendimit*).

7. Shumica ka arritur në përfundimin se kërkesa e gjykatës referuese duhet të rrezohet, pasi është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës veprë penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre (*shih paragrafët 36, 44 - 46 të vendimit*). Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, kushtetutëbërësi ka shtuar në nenin 135, pikat 2 dhe 4 që përmbajnë rregullime për gjykatat e posaçme, duke synuar të parashikohet në nivel kushtetues dhe për herë të parë ngritja e një gjykate të re me juridiksion lëndor të posaçëm në fushën penale, e cila ka kompetencën të gjykojë disa kategori veprash penale brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, konkretisht ato të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si edhe akuzat penale kundër një kategorie funksionarësh të lartë (*shih paragrafin 37 të vendimit*). Sipas shumicës, neni 135, pika 2, i Kushtetutës jo vetëm nuk përmban një ndalim të shprehur, por as nuk mund të interpretohet se juridiksioni i gjykatave të posaçme përjashton kompetencën e gjykatave të zakonshme për gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin (*shih paragrafin 39 të vendimit*). Në këndvështrim të nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, kategoritë e veprave penale të korrupsionit duhet të jenë të tilla që për nga mënyra se si kryhen, rrethanat apo edhe pasojat e ardhura, të mund të kenë peshë të barasvlefshme me ato të krimit të organizuar, të cilat konsiderohen nga ato lloj veprash penale që rrezikojnë bazat e shtetit dhe organizimin shoqëror. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim të përfshijë të gjitha veprat penale të korrupsionit në kompetencë të gjykatave të posaçme dhe se bazuar në këtë qëllim të kushtetutëbërësit, ligjvënësi ka kategorizuar në dispozitën e

kundërshtuar ato vepra penale që shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe ato që shqyrtohen nga gjykatat e posaçme, referuar vlerës së përfituar (*shih paragrafin 43 të vendimit*).

8. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Duke iu referuar thelbit të çështjes konkrete, do të duhej që shumica të kontrollonte pajtueshmërinë kushtetuese të dispozitës së kundërshtuar, duke interpretuar në mënyrë përfundimtare jo vetëm nenin 135 të Kushtetutës, por edhe nenet 148, pika 4 dhe 148/dh të saj, pasi kompetenca e gjykatës së posaçme është e lidhur dhe reflekton tek kompetencat e Prokurorisë së Posaçme dhe të Njësisë së Posaçme Hetimore. Në këtë mënyrë, vlerësimi i Gjykatës për kompetencën e gjykatës së posaçme ndikon drejtpërdrejt edhe në përcaktimin e kompetencave të këtyre dy organeve të tjera kushtetuese. Duhet theksuar se këto norma kushtetuese janë pjesë e së njëjtës reformë kushtetuese të vitit 2016 dhe kanë edhe lidhje organike midis tyre, sepse i shërbejnë krijimit, organizimit dhe funksionit të strukturave të posaçme kushtetuese për ndjekjen dhe gjykimin, ndër të tjera, edhe të veprave penale të korrupsionit. Më konkretisht, këto dispozita garantojnë organizimin dhe funksionimin në mënyrë të pavarur të organeve kushtetuese, të shprehura specifikisht si *gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar* (neni 135, pika 2); *Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar* (neni 148, pika 4); dhe *Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme* (neni 148/dh, pika 1).

10. Në ndryshim nga shumica vlerësojmë se qëllimi i kushtetutëbërësit në krijimin e këtyre strukturave të posaçme në nivel kushtetues ka qenë lufta efikase jo vetëm ndaj krimit të organizuar, por edhe ndaj të gjitha veprave penale të korrupsionit, veçanërisht kur lufta ndaj këtij të fundit përbën kusht të domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe forcimin e shtetit ligjor, si dhe një prej përparësive të Shqipërisë në procesin e integritimit evropian. Ky qëllim i kushtetutëbërësit është evidentuar qartësisht në Komentarin “Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016)”, të hartuar nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, të cilët ndihmuan në hartimin e ndryshimeve kushtetuese, sipas të cilit: “*Gjykata e Posaçme së bashku me Prokurorinë e Posaçme dhe Njësinë e Posaçme hetimore do të hetojnë, procedojnë dhe gjykojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ligjvënësi kushtetues, me reformën në sistemin e*

*drejtësisë, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë ngritjes së mekanizmave për goditjen në mënyrë efektive të veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe abuzimit me detyrën.”<sup>1</sup>*

11. Gjykata ka theksuar se Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore e politike të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore. Por, Kushtetuta, përveç kësaj, mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst është e vërtetë që neni 135, pika 1, i Kushtetutës parashikon se Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat ushtrojnë pushtetin gjyqësor, krijohen me ligj. Mirëpo, rregulli për krijimin me ligj të gjykatave nuk duhet interpretuar se i jep Kuvendit diskrecionin që të ndërhyjë në kompetencat e gjykatave, kur ato janë të përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta, sepse një ndërhyrje e tillë ndalohet shprehimisht nga neni 6 i saj, i cili parashikon se organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në të rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Për sa i takon kompetencës lëndore të gjykatës së posaçme, ajo është e parashikuar shprehimisht në pikën 2 të nenit 135 të Kushtetutës dhe për këtë shkak kjo kompetencë nuk mund të rregullohet ndryshe me ligj.

12. Ky përfundim përforcohet edhe nga përmbajtja e pikës 3 të nenit 135, sipas të cilit Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme. Me fjalë të tjera, kushtetutëbërësi ka autorizuar Kuvendin të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta (pra, me kompetencë lëndore specifike) nga ato të krijuara shprehimisht nga Kushtetuta, siç janë gjykatat e posaçme, por edhe Gjykata e Lartë.

13. Ashtu siç pohon shumica, përdorimi i lidhëzës “dhe” në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 135 nuk është i paqëllimtë. Qëllimi i normës kushtetuese ka qenë që të kategorizojë brenda juridiksionit penal të posaçëm ato vepra penale të të njëjtit nivel për nga rëndësia dhe natyra e tyre (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Megjithatë nuk pajtohem me vlerësimin se Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim të përfshijë të gjitha veprat penale të korrupsionit në kompetencë të gjykatave të posaçme apo thënë ndryshe se disa vepra penale të korrupsionit

---

<sup>1</sup> Shih: <http://ipls.org/wp-content/uploads/2020/07/Komentar-Mbi-reformen-kushtetuese-final.pdf-faqe-149>, paragrafi 17, faqe 311, paragrafi 3 dhe faqe 374, paragrafi 1 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

janë më pak të rëndësishme për t'u luftuar se sa disa të tjera, referuar vlerës së përfituar nga sjelljet korruptive, për rrjedhojë ligjvënësi mund të miratojë me ligj rregulla që këto lloj veprash penale të hiqen nga kompetenca lëndore e gjykatës së posaçme.

14. Në vlerësimin tonë, qëllimi i normës kushtetuese ka qenë njësimi i rëndësisë që kanë fenomenet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar për shtetin e së drejtës, që dikton edhe luftën e njëjtë ndaj tyre me struktura të dedikuara në nivel kushtetues dhe me garancitë funksionale të nevojshme. Në këtë pikëpamje, ashtu siç nuk bëhen ndarje të veprave penale të krimit të organizuar në të rëndësishme ose jo, ashtu nuk duhet të bëhen ndarje edhe për veprat penale të korrupsionit, sepse të gjitha këto vepra penale duhen luftuar, me qëllim çrrënjosjen pa kompromis të fenomenit të korrupsionit.

15. Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në ditët e sotme përbëjnë një prej shqetësimeve më serioze të shoqërisë shqiptare, ashtu siç është edhe krimi i organizuar. Korrupsioni dhe krimi i organizuar meritojnë të etiketohen “gangrenë” e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, që gërryen qeverisjen e vendit, cenon deri në mohim të drejtat e njeriut dhe shkatërron besimin publik te shteti i së drejtës. Duke iu referuar konkluzioneve dhe rekomandimeve të Raportit të Barometrit për Ballkanin për vitin 2022 – Opinioni Publik, vihet re se: *“Lufta kundër korrupsionit duhet të jetë, gjithashtu, në mënyrë efektive ndër prioritetet e para të qeverive të të gjitha ekonomive dhe të palëve të tjera të interesuara, pasi jo vetëm që gërryen besimin në institucionet publike, por edhe minon mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.”*<sup>2</sup> Po aty është evidentuar se tendenca më e rëndësishme që nga viti 2020 është rritja me 10% e masës së atyre që e shohin korrupsionin si çështjen më shqetësuese (nga 19%).<sup>3</sup>

16. Gjetjet e studimeve në këtë fushë tregojnë se shqiptarët mendojnë se korrupsioni është një rrezik më i lartë për sigurinë sesa krimi i organizuar. Konkretisht, 39.3% e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni është kërcënimi kryesor për sigurinë në Shqipëri, në raport me 11.2 % që e kanë konsideruar krimin e organizuar si kërcënimin më serioz për sigurinë<sup>4</sup>.

17. Po kështu, forcimi i masave në luftën kundër korrupsionit ka qenë kërkesë permanente dhe parësore e strukturave të Bashkimit Evropian, por edhe e partnerëve të tjerë

---

<sup>2</sup> Shih <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications> – BB 22 “Balkan Barometer 2022 – Public Opinion”, fjalia e fundit në faqen 150 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

<sup>3</sup> Po aty, paragrafi i dytë në faqen 135 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

<sup>4</sup> Shih <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2022/06/BSHS-2022-ALB.pdf> - Barometri i Sigurisë Shqipëri – Anketë Kombëtare, faqe 24 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.



evropianë e më gjerë që mbështesin Shqipërinë në rrugëtimin e saj drejt integritimit në strukturat evropiane dhe në forcimin e shtetit të së drejtës. Kështu, Komisioni Evropian në opinionin për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian COM(2010)680, datë 09.11.2010, ka evidentuar se: “*Shqipëria ka bërë përpjekje gjatë viteve të fundit për të krijuar një kuadër ligjor dhe institucional për të luftuar korrupsionin, i cili tashmë është gjerësisht i vendosur. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe përbën një problem veçanërisht serioz [...]. Shqipëria duhet të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe të adresojë pengesat për hetime efektive, veçanërisht të gjyqtarëve, ministrave dhe deputetëve që lidhen me imunitetin e pakufizuar të këtyre zyrtarëve publikë. Duhet të sigurohet zbatimi i plotë i strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit dhe të krijohet një histori solide e hetimeve dhe ndjekjeve proaktive, si dhe e aktakuzave dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet.*”<sup>5</sup>

18. Gjithashtu, në raportin e datës 24.09.2019, parlamenti gjerman (*Deutscher Bundestag*), ndër të tjera është shprehur se “*për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar u krijua struktura e posaçme e kërkuar SPAK, një gjykatë e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar [...]. Ndërkohë që hetimet proaktive, ndjekjet penale dhe dënimet në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar janë duke u zhvilluar, ato duhet të ndiqen me shpejtësi dhe energji në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe ato ndaj zyrtarëve të lartë dhe politikanëve [...]. Konferenca e dytë e anëtarësimit do të zhvillohet vetëm dhe kapitujt e parë të negociatave nuk do të hapen derisa qeveria federale të ketë përcaktuar se Shqipëria plotëson kushtet e mëposhtme: [...] Ngritja e strukturës së posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe aftësinë e tyre për të punuar [...].*”<sup>6</sup>

19. Ndërsa përpara çeljes së negociatave, në mbledhjen e 25 marsit 2020, Këshilli Evropian rikonfirmoi mbështetjen politike dhe strategjike për anëtarësimin e Shqipërisë në BE dhe evidentoi se përgjegjësia për nisjen e negociatave iu takon autoriteteve shqiptare me plotësimin e kushteve. Ndër to përfshihen përfundimi i krijimit të strukturave të specializuara që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përmes bashkëpunimit me vendet anëtare të BE-së dhe një planveprimi për zbatimin e rekomandimeve të FATF-ës (*Financial Action Task Force*), si dhe pasja e një

---

<sup>5</sup> <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/opinioni.pdf> - faqe 6 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

<sup>6</sup> <https://dserver.bundestag.de/btd/19/135/1913509.pdf> - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.



baze të gjurmueshme të dhënash solide për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet, përfshirë nisjen dhe përfundimin e procedimeve të para kundër zyrtarëve të lartë dhe politikanëve.<sup>7</sup>

20. Në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut të vitit 2021, është evidentuar: “Çështjet kryesore të të drejtave të njeriut përfshin: problemet me pavarësinë e gjyqësorit teksa ai vazhdon të nënshtrohet vetingut; kufizimet ndaj shprehjes së lirë dhe shtypit; korrupsionin e përhapur në të gjitha degët e qeverisë dhe institucionet bashkiake. Pandëshkueshmëria mbeti problem serioz, megjithëse Struktura e Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit dhe gjykatat kundër korrupsionit përparuan dukshëm gjatë vitit në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e zyrtarëve të lartë dhe kriminelëve.”<sup>8</sup> Sipas këtij raporti, korrupsioni ka shtrirje në burgje dhe qendra paraburgimi, gjyqësor, media, qeveri dhe polici, që do të thotë se ai është i përhapur në shumë sektorë, përtej krimit të organizuar.

21. Së fundmi, vlerësojmë se nuk qëndron argumenti i parashtruar nga subjektet e interesuara se ligjvënësi mund të rregullojë kompetencën lëndore për disa vepra penale që nuk kanë rëndësi të veçantë, me qëllim rritjen e eficiencës së veprimtarisë së gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme. Më konkretisht, ato janë shprehur se përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në varësi të vlerës së përfitimit krijon mundësi reale që Prokuroria e Posaçme të fokusohet në ato çështje penale të cilat kanë rëndësi të veçantë për shkak të natyrës së tyre, rrezikshmërisë së lartë shoqërore, ndikimit të pasojave që ato sjellin në shoqëri, si dhe nivelit të korrupsionit dhe se dispozita objekt gjykimi kushtetues synon, gjithashtu, edhe garantimin e standardit të procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë edhe atë të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm (shih paragrafin 30 të vendimit). Mirëpo, siç ka pohuar Gjykata në çështje kushtetuese të lidhura me respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, ngarkesa e punës nuk përbën argument kushtetues (shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Për më tepër, vetë kushtetutëbërësi ka përcaktuar garanci të tilla kushtetuese që t’i përgjigjen performimit profesional të gjykatave të posaçme që gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë edhe Prokurorinë e Posaçme, ku, për këtë të fundit, në nenin 148/dh, pika 2, është përcaktuar qartësisht përbërja “nga të paktën 10 prokurorë”. Në thelb të

<sup>7</sup> Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf> - faqe 5 - aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

<sup>8</sup> Shih: <https://al.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/> - Rubrika “Marrëdhënia Jonë”/Nënrubrika “Raporte Zyrtare”/Raporti për të Drejtat e Njeriut 2021 – Shqipëria (WORD DOC 181 KB), faqe 1 – aksesuar për herë të fundit më 25.07.2022.

këtyre garancive qëndron fakti se organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, sikurse Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, kanë kompetencën kushtetuese për të marrë masat e duhura për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme që hetojnë dhe gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar (nenet 149, pika 1 dhe 147, pika 1, të Kushtetutës). Po kështu, gjyqtarët dhe prokurorët e këtyre strukturave rekrutohen sipas një skeme të posaçme kushtetuese, me theks te profesionalizmi, pavarësia dhe integriteti (nenet 135, pika 4, 148, pika 4 dhe 148/dh, pikat 2, 3 dhe 5, të Kushtetutës). Kjo zgjidhje kushtetuese pa asnjë dyshim i shërben efektivitetit të këtyre strukturave dhe njëherazi edhe ndjekjes së politikës penale të unifikuar në luftën kundër korrupsionit, e cila, me zgjidhjen që ka bërë Kuvendi, rrezikon të copëzohet.

22. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, vlerësojmë se kërkesa e gjykatës referuese duhet të ishte pranuar, pasi togfjalëshi “paragrafi 2”, pas “244”, në shkronjën “a” të nenit 7 të ligjit nr. 41/2021 bie në kundërshtim me nenet 135, pika 2, 148, pika 4 dhe 148/dh të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, duhet të ishte shfuqizuar.

**Anëtare: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari**